



24 gusht 2021

Njoftim

KONSULTIM PUBLIK

Përshtatjet vjetore për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar të energjisë elektrike (OST/OT, OSSH dhe FSHU)

Zyra e Rregullatorit për Energji, njofton të gjitha palët e interesuara se ka vendosur në konsultim publik Raportet për Përshtatjet e Rregullta Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga kompanitë e rregulluara të energjisë elektrike. Në këto raporte konsultative ZRRE-ja ka bërë publik propozimin fillestar për MAR-et e azhurnuara për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS) dhe do të përcaktojë të hyrat e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU). Ky vlerësim fillestar bazohet në propozimet e dorëzuara nga kompanitë e rregulluara si dhe vendimet për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2018-2022 për OST/OT dhe OSSH.

Procesi i përshtatjeve për vitin relevant tarifor 2021 përfshin periudhën 1 prill 2021 - 31 mars 2022, por duke marr parasysh mungesën e funksionimit të Bordit të ZRRE, ky proces është shtyrë dhe vonesa e marrjes së vendimeve për të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe të tarifave për këtë vit relevant tarifor, do të azhurnohen në vitin e ardhshëm tarifor 2022.

Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale – MAR është proces i rregullimit të çmimit që përdoret nga ZRRE në mënyrë që kompanitë e rregulluara të mbledhin të hyrat e tyre të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të rregulluara.

ZRRE të gjitha palët tjera e interesuara, që të japin kontributin e tyre në këtë proces, duke shqyrtuar dhe komentuar të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS).

Palët të cilat dëshirojnë të paraqesin komentet e tyre rreth propozimeve të ZRRE-së, ftohen që t'i dorëzojnë ato me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se deri me 07 shtator 2021. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen edhe me postë në adresën:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë